



Prishtinë, 29.01.2024
Kodi i ZRRE-së: V_1863_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2464_11_23** i dt.20.11.2023;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **27.12.2023**.

në seancën e mbajtur më datë **29.01.2024** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin B.S nga komuna e Vushtrrisë, si e pa bazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2464_11_23 i dt.20.11.2023.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 20.11.2023 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2464_11_23 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjën e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 31.06.2023 lidhur me kontestimin e korrigjimit plotësues nr. 34480DMI-32131 datë 19.06.2023, për shkak të matjes jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 34725754.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njëjti është i padrejtë;
- Pretendon se faturimi dhe korrigjimi i konsumatorit është real dhe është bere bazuar ne procesverbalin e kalibrimit;
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2464_11_23 i datës 20.11.2023 për konsumatorin B.S

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Lidhur me pretendimin e KESCO se vendimin nr. ZRRE/DMK_V_2464_12_23 i datës 20.11.2023 i Departamentit për Mbrojtjen e konsumatorëve nuk është i drejt, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe shkresave si: Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0032324 datë 26.05.2022; Protokoli i verifikimit të njehsorit elektrik-mekanik në qendrën laboratorike Nr.org.02Nr. 1682 datë 06.03.2023; Korrigjimi nr. 34480DMI-32131 datë 19.06.2023; Ankesat e konsumatorit datë 21.06.2023 dhe 22.06.2023; përgjigja e KESCO-s date 30.06.2023; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 07.07.2023; Vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_2464_11_23 i datës 20.11.2023, Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike, listat e leximi, ka gjetur se nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

ZRrE ka vërejtur se, me datë 26.05.2022 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 34725754 me gjendje TL=51030 kWh dhe TU=42980 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 20092767 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipet e KEDS-it kanë evidentuar dhe behet ndërrimi i njehsorit të vjetër i cili zhvendoset, dhe se njehsori i vjetër dërgohet në qendrën e kalibrimit.

Me datë 06.03.2023 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes për njehsorin elektrik nr. 34725754 me gjendje të shpenzimeve TL=51031 kWh dhe TU=42981 kWh ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik nuk është në rregull, njehsori elektrik ka probleme me sistemet e fazave të matjes, njehsori elektrik bllobat(vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka kurse gabimi në matje në T1 është **-66.55%** dhe në T2 është **-68.55%**. Në procesverbal po ashtu është evidentuar vërejtja se: njehsori elektrik nuk regjistron energjinë elektrike në sistemin e fazës së dytë S dhe të tretë T. Bordi i ZRRE-së bazuar në analizën e procesverbalit të shqyrtimit konstaton se njehsori elektrik është jashtë kufijve të lejuar të matjes e që bazuar në Kodin e matjes së OSSH-së është **+2.5%**.

Bordi i ZRRE ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit dhe konstaton se lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektim dhe lexime të rregullta mujore dhe se pothuaj se në të gjitha periudhat sa njehsori elektrik nr. 34725754 ka qenë i vendosur për matje ka evidentuar që mungon vula(bllomba) si dhe ka evidentuar sugjerim për zhvendosje. Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka dallim në shpenzimin e energjisë elektrike. Bazuar në krahasimin e shpenzimeve të energjisë elektrike me dy njehsorët elektrik, nr. 34725754 dhe nr. 20092767 vërtetohet se konsumatori në krahasim me periudhat e njëjta të mëshme dhe të mëvonshme ka ndryshim. Sipas rrjedhës së energjisë mesatarja e shpenzimeve me njehsorin e vjetër kontestues nr. 34725754 për periudhën 12/2021 deri në periudhën 03/2022 është 1,308 kWh/muaj, periudhën 12/2020 deri në periudhën 03/2021 është 1,256 kWh/muaj si dhe periudhën 12/2019 deri në periudhën 03/2020 është 1,240 kWh/muaj, kurse me njehsorin e ri nr. 20092767 periudha 12/2022 deri në periudhën 03/2023 është 2,755 kWh/muaj. Bordi i ZRRE-së me qëllim të analizimit të mëtutjeshëm të shpenzimeve ka bërë edhe krahasimin nëntë mujor të shpenzimeve me dy njehsorët, ku sipas shpenzimeve të regjistruara me njehsorin e vjetër nr. 34725754 për periudhën 07/2021 deri në periudhën 03/2022 është 805 kWh/muaj kurse me njehsorin e ri nr. 20092767 mesatarja mujore për periudhën 07/2022 deri në periudhën 03/2023 është 1,593 kWh/muaj. Bordi i ZRRE-së bazuar në të gjitha analizat e bëra konstaton se konsumatori ka rritje të shpenzimit pas ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 34725754. Po ashtu Bordi i ZRRE-së vëren se konsumatorit në periudhën 03/2023 përkatësisht me datë 17.03.2023 me kërkesë të tij i është larguar nga matja njehsori elektrik nr. 20092767 dhe i është vendosur njehsori me n. 87409648.

Me datë 19.06.2023 Departamenti i faturimit në KESCO bazuar në procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0032324 datë 26.05.2022 dhe protokolit të verifikimit të njehsorit elektrik-



mekanik ne qendrën laboratorike Nr.org.02Nr. 1682 datë 06.03.2023 përmes korrigjimit nr. 34480DMI-32131 ka bërë korrigjimin plotësues në vlerë **983.55€** duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 12(24 dite)/2021 deri më datë 06(6ditë)/2022. Ne nenin 4.11.1 te Kodit te Matjes se energjisë elektrike te OSSH thuhet se:” *Pasaktësia e matjes ka kuptimin kur ndonjë element matës ka defekt elektrik/fizik të tij dhe si rezultat kufiri i saktësisë së matjes mund të jetë vlerë e përcaktuar apo e papërcaktuar Ne rastin e përcaktimit te pasaktësisë ne matje, e cila nënkupton pasaktësinë e vetë njehsorit apo edhe ne tërësi te sistemit matës apo ndonjë elementi te tij (pasaktësia nënkupton edhe lidhjen jo adekuate te sistemeve matëse te rrymave dhe tensioneve si ne aspektin e drejtimit ashtu edhe te fazave përkatëse), pas testimit të pajisjeve matëse dhe/apo përcaktimit të pasaktësisë së sistemit matës apo ndonjë elementi te tij në formë empirike ose testimit te tij dhe pasi që të vërtetohet kufiri i pasaktësisë, përpilohet raporti për gjendjen dhe vlerat e testuara të pajisjeve matëse dhe/apo definimit te përqindjes se pasaktësisë se sistemit matës apo ndonjë elementi te tij. Pavarësisht a është gabimi në plus ose minus dhe tejkalon vlerën 3 herë të klasës së saktësisë (p.sh. për njehsorët e drejtpërdrejtë klasa e saktësisë është 2.0, kufiri i lejuar do të ishte 6.0%) atëherë bëhet ri–llogaritja e energjisë dhe përmirësimi i faturimit për 12 (dymbëdhjetë)muajt e fundit për konsumator jo shtëpiak përkatësisht 6(gjashtë) muajt e fundit për konsumatorët shtëpiak, sipas vlerës se përcaktuar te gabimit”. Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar korrigjimin e bere nga KESCO por qe konstaton se ky korrigjim nuk mund te paraqet shpenzim real te konsumatorit andaj duke pasur parasysh se konsumatori ka rritje te shpenzimi pas vendosjes se njehsorit nr. 20092767 konstaton se korrigjimi i faturave duhet te behet bazuar ne shpenzimet e konsumatorit per periudha te njëjta me njehsorët elektrik të ri nr. 20092767 dhe nr. 87409648*

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, e ne veçanti rrjedhën e energjisë elektrik, procesverbalit mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr. 0032324 datë 26.05.2022 dhe protokolit i verifikimit te njehsorit elektrik-mekanik ne qendrën laboratorike Nr.org.02Nr. 1682 datë 06.03.2023 përmes korrigjimit nr. 34480DMI-32131 datë 19.06.2023 dhe Kodit te Matjes së energjisë elektrike të OSSH, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet ne gjuhet zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Arta Qorolli, anëtare

Adnan Preniqi, anëtar

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **B.S** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.